



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA
KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
/GOVERNMENT OF KOSOVO



SEKRETARIATI - KËSHILLIT KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE
INVESTIME

PROCESVERBAL

**Mbledhja e Dytë
(Virtuale)**

E martë, 24 Nëntor 2020, ora **12:00**

Prishtinë

Mbështetur nga:



European Bank
for Reconstruction and Development



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF
KOSOVA**

**Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë
Sekretariati i
KKEI**

Mbledhja e Dytë – 24 Nëntor 2020

Rendi i ditës

(Moderimi bëhet nga ana e Sekretariatit të KKEI)

- 12:00 – 12:10 Fjala Hyrëse – Kryesuesi i KKEI - z.Avdullah Hoti, Kryeministër i Kosovës
Aprovimi i Procesverbalit të mbledhjes së parë të KKEI dhe i rendit të ditës
- 12:10 – 12:35 Diskutim lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e KKEI- Ministrat:
- znj. Hykmete Bajrami, Ministre e Financave
 - z. Blerim Kuçi, Ministër i Ekonomisë dhe Ambientit
 - z. Vesel Krasniqi, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë
 - z. Fehmi Mehmeti, Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës
- 12:35 – 12:45 Prezantim i Sekretariatit – Notë Përmbledhëse dhe plani i veprimit për grupet
punuese - znj.Lindita Daija – Udhëheqëse e Sekretariatit të KKEI
- 12:45 – 13:15 Diskutime nga anëtarët e KKEI - Asociacionet e Bizneseve
- 13:15 – 13:20 Diskutime tjera
- 13:20 – 13:30 Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores së KKEI-së
- 13:30 – 13:35 Konkluzionet, Kryesuesi i KKEI z. Avdullah Hoti, Kryeministër i Kosovës
Caktimi i datës së mbledhjes të ardhshme të KKEI

Avdullah Hoti (Kryeministër):

Kërkojmë ndjesë që po fillojmë pak me vonesë!

Nëse jeni dakord të gjithë, meqë kemi këtu odat ekonomike, Kryetarët e odave, Ministrat ose Zv. Ministrat që i zëvendësojnë, do të fillonim takimin sipas agjendës të cilën e keni marrë.

Pra, kjo është mbledhja e dytë e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, kërkojmë mirëkuptim që e kemi caktuar dy herë mirëpo na është dashur ta shtyjmë për shkaqe objektive të organizimit në këtë situatë. Edhe sot dy prej ministrave nuk i kemi prezent për shkak që janë të prekur me Corona dhe duhet të qëndrojnë të izoluar.

Unë propozoj të vazhdojmë sipas agjendës të cilën e keni marrë, me përjashtim të rregullores, të cilën duket se do të duhet ta shikojmë edhe njëherë, për shkak se sapo e kemi miratuar Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Zyrës së Kryeministrit, ku i kemi integruar zyret edhe janë disa çështje që më shumë janë parimore dhe ligjore që duhet t'i marrim parasysh me finalizimin e kësaj rregullore, sepse me këtë rregullore përveq funksionimit të Këshillit parashihet edhe Sekretariati dhe ne duhet ta integrojmë brenda Zyrës së Kryeministrit këtë Sekretariat.

Atëherë më lejoni që t'i prezantoj disa qëndrime të mijat si fjalë hyrëse, disa vlerësime të mijat për punën e përbashkët që e kemi bërë deri më tash, dhe pastaj do t'i lus ministrat ose zv. ministrat që të marrin fjalën dhe të mbulojnë qështjet që janë në fushëveprimtarinë e tyre.

Unë po e shfrytëzoj rastin që të falënderoj odat ekonomike, shoqatat e ndryshme për të gjitha komentet që kanë dërguar, edhe Sekretariatit e Këshillit, Linditën me bashkëpunëtorët e tjerë të saj që kanë sistemuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga odat ekonomike, bashkë me Zyrën për Planifikim Strategjik, profesor Gazmendin dhe të tjerët, të cilat i kanë marrë ministrat, të përmbledhura qështjet nga odat ekonomike dhe pres nga ministrat që në fjalët e tyre t'i adresojnë konkretisht qështjet e ngritura nga odat ekonomike.

Orientimi jonë është që menjëherë t'i adresojmë qështjet që mund t'i adresojmë tash, dhe do t'i ndëgjojmë ministrat se çka kanë për të thënë, odat dhe pastaj të dakordohemi për një listë të reformave për një pako të re fiskale të cilën duhet të fillojmë ta zhvillojmë, ta përgatisim menjëherë pas këtij takimi, me objektivë që nga fundi i vitit apo në Janar të jetë e kryer për aq sa ka mundësi me legjislacionin sekondar. Nëse ka qështje që duhen të adresohen përmes ligjeve, sigurisht ajo na merr kohë pastaj në parlament e kështu me rradhë.

Sa i përket situatës ekonomike, ju jeni drejtëpërdrejtë të përfshirë. Vlerësimet fillestare ishin që ne nuk do të përballeshim me intensitetin e pandemisë siç jemi duke duke u përballur tash, edhe pritjet tona kanë që ne vitin ta mbyllim me pasoja dukshëm më të vogla të pandemisë se sa tash që i kemi vlerësimet e fundit nga Banka Qendrore e Kosovës, të cilat shkojnë deri në 7%.

Qëllimi jonë, objektivi jonë mbetet që deri në fund të vitit ne të kompensojmë ekonominë pothuajse plotësisht përmes pakos për rimëkëmbje ekonomike, pothuajse plotësisht për efektet që kanë pas bizneset si rezultat i pandemisë. Sigurisht, jo kokë për kokë, pra jo çdo biznes për pasojat që ka pasur, mirëpo në total, pra nëse merret infuzioni që i japim biznesit përmes qeverisë, shkon rreth 5% të Bruto Produktit Vendor që është gati e barabartë me pasojat që ka pasur ekonomia si rezultat i pandemisë.

I kemi parë edhe vendimet e fundit të cilat i kemi marrë, shumën prej 87 milionë euro që e kemi ndarë, pjesën më të madhe për ekonominë, përfshirë edhe 60 milionëshin që është ndarë tashmë për biznese, me procedura shumë të thjeshta, pa procedura të aplikimit, vetëm duke marrë parasysh numrin e të punësuarve, duke përjashtuar disa kategori të kompanive që funksionojnë në tregje të rregulluara. Tani Ministria e Financave është duke e bërë gati pakon tjetër që prek ndërmarrjet me vetëm një punëtorë, që janë bukur shumë, por nga kjo shumë prej 60 milionë euro, janë ndihmuar rreth 36,679 biznese, me

respektivisht 206,582 punëtorë. Dhe ndihma që kanë marrë, ka qenë e barabartë ndoshta tek 80% e pagës mesatare mujore që marrin punëtorët në sektorin privat, në mesatare po flasim pra, duke përfshirë edhe ndihmën që është marrë në pjesën e parë të vitit përmes pagesës së qirave ose formave të tjera. Besoj që është ndihmë simbolike, mirëpo ndihmon që bizneset të qëndrojnë në treg sepse fokusi jonë në periudha afatshkurtra është që të ndihmojmë bizneset të qëndrojnë në treg, me shpresë që do ta tejkalojmë këtë pandemi dhe pastaj të kthehemi në aktivitet normal ekonomik.

Masat tjera të cilat i kemi dakordu së bashku, disa prej tyre kemi filluar t'i zbatojmë, përveq 60 milionëshit të cilën e përmenda më heret. Janë disa pako që prekin disa grupe të caktuara të biznesit dhe shoqërisë, siç është Masa Nr. 10 që i targeton femrat dhe punësimin e femrave në shumë prej 2 milionë eurove, ju informoj që të gjitha procedurat janë kryer, me shpallje me përzgjedhje, dhe unë pres që nesër të kemi nënshkrimin e disa prej kontratave, mbështetjeje që Zyra për Barazi Gjinore këtu në zyrën e Kryeministrit, do të ndajë mjete për femrat në biznes. Mbështetje të veçantë për komunitetin, poashtu në shumë prej 2 milionë eurosh. Edhe këtu janë kryer të gjitha procedurat, por është qështje javësh, të gjitha këto mjete do të hyjnë në ekonomi.

Ministria për Zhvillim Rajonal, besoj që keni qenë të përfshirë në procedurat e përzgjedhjes, prap një shumë prej 2 milionë eurove, e kemi ndihmuar me 5 milionë euro Ministrinë e Kulturës për të gjitha Federatat Sportive, për qështje të rinisë dhe qështje të kulturës. Unë isha vet prezent, para dy javëve me Ministren Dumoshi kur i takuam të gjitha federatat sportive. Dua të them që sporti është bërë biznes, sektor në vete, sipas informatave që kemi marrë nga të gjitha federatat janë mbi 25,000 veta të përfshirë në forma të ndryshme, në të gjitha klubet e ndryshme, në të gjitha llojet e sportit, vërtet është industri e madhe.

Në Ministrinë e Ekonomisë poashtu është një shumë prej 1 milion për qështje të ndërmarrësisë, me sa di këtu është zv. Ministri Nitaj, na informon më vonë, por ende nuk janë zhvilluar të gjitha procedurat. Në bujqësi, Ministrin e Bujqësisë e kemi këtu, besoj që flet më vone. Tanimë kemi ndarë 12 milionëshin e parë, për 24 milionë shtesë që kemi ndarë për dyfishimin e subvencioneve në bujqësi, pra këto janë masat që kemi ndërmarrë deri më tash. Ministrat do të ju informojnë më në detaje për veprimet e tyre edhe do t'i adresojmë qështjet që ju i keni ngritur në Sekretariatit e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime. Në fund atë që deshta të sjellë në vëmendjen e juaj është një listë e zhvillimeve të marrëveshjeve ekonomike dhe politike që lidhen me Kosovën, për të cilën besoj që komuniteti jonë i biznesit duhet të jetë i përgatitur për këto zhvillime në muajt e ardhshëm. Ndoshta e kemi diskutuar edhe më herët marrëveshjen e Washingtonit, ku është një listë bukur e gjatë e projekteve infrastrukturore dhe energjetike për të cilat komuniteti i biznesit dhe odat ekonomike duhet të na ndihmojnë, dhe duhet të bëhen gati për të qenë pjesë e zbatimit të këtyre marrëveshjeve, pjesë e procedurave për zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Në veqanti hekurudhën edhe autostradën, por edhe gazin, sjelljen e gazit në Prishtinë, fillimisht nga Shkupi por edhe hekurudha për Durrës që janë projekte të mëdha që kërkojnë përfshirje bukur të gjerë ndërsektoriale të bizneseve.

E dyta është lista e projekteve investive të cilën ne e kemi përgatitur në Qeveri e që është "kros sektoriale" në bazë të cilave ne do të fillojmë, dhe të shohim tash se cilat mund t'i mbulojmë me buxhet të rregullt e cilat duhet të kërkojmë borxhe ndërkombëtare dhe cilat i financojmë bashkë me donatorët dhe me partnerët e tjerë zhvillimorë.

Ju informoj gjithashtu që në pjesën e parë të Dhjetorit do ta kemi një konferencë, po e quaj "të koordinimit" me donatorët, për qështje të rimëkëmbjes ekonomike sepse tani është momenti që një numër i madh i donatorëve, duke përfshirë agjencitë e OKB-së, që janë bukur shumë dhe shpenzojnë bukur shumë në Kosovë, në baza vjetore. Pastaj USAID, KfW dhe donatorë të tjerë që punojnë në Kosovë do të ulemi t'i bëjmë bashkë përpjekjet tona dhe fondet tona për vitin 2021, pra mbështetjen që duhet

t'i japim bizneseve për vitin 2021, në mënyrë që ne ta zhvillojmë pakon e rimëkëmbjes për pjesën e parë të vitit të ardhshëm.

Ju informoj këtu që pjesë e buxhetit për vitin 2021 tashmë është bërë fondi për rimëkëmbje ekonomike në shumën prej 182 milionë euro, dhe siç kemi punuar deri tash me komunitetin e biznesit, me odat dhe me shoqatat e ndryshme, do të ulemi bashkë që të dizajnojmë këto masa për këtë pako ekonomike. Me këtë rast unë dëshiroj të falenderoj edhe UNDP për mbështetjen që na ka dhënë në zhvillimin e planit operacional për implementimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike përmes përgatitjes së dokumentit për fazat që duhen të ndiqen duke i sistemuar edhe përvojat më të mira, dhe vërtet na ka ndihmuar bukur shumë në përgatitjen e kriterëve për secilën prej masave që kemi kaluar në Qeveri, përpara se ti bënim publike, duke filluar nga shuma prej 60 milionë eurove, pastaj për Bujqësi e për Femrat në Ekonomi, Mbështetjen për Komunitetet e Zhvillim Rajonal e kështu me radhë. Në fund dëshiroj të falenderoj BQK, ne kemi pasur një takim me Ministren Financave, një takim me ata para 3 javëve dhe kam pranuar një listë të rekomandimeve nga bizneset për qështjet që duhen të adresohen në banka komerciale përmes Bankës Qendrore dhe këtu përfshihet rishikimi edhe të rregullativës së nevojshme që nxjerr BQK sa i përket klasifikimit të kredive, sa i përket përcaktimit të tarifa të ndryshme për shërbimet që i ofrojnë bankat dhe në veqanti adresimin e disa çështjeve që i kemi diskutuar me profesor Gazmendin në takimin e fundit që kam pasur me Odën e Afarizmit të Kosovës e cila në mënyrë sistematike ka dorëzuar një listë të çështjeve që me të drejtë besoj duhet të adresohen nga Banka Qendrore e Kosovës. Besoj që zv Guvernatori Havolli është me ne këtu dhe i ka parë vërejtjet e Odës së Afarizmit dhe të odave tjera në mënyrë që të kemi një përgjigje nga ana e tyre për ato shqetësime dhe në veqanti për hapat që duhet të ndërmerim për t'i adresuar ato vërejtje/shqetësime në javët e ardhshme.

Unë po e përfundoj këtu dhe ju falënderoj shumë!

Nëse Lindita është dakord, unë do të i'a kaloja Linditës moderimin e këtij takimi më tutje, dhe e do të lutesha që ministrat të marrin fjalën në vijim, duke filluar nga zv. Ministri i Financave z. Krasniqi, pastaj zv. Ministri Nitaj, nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, besoj që është prezent dhe zv. Guvernatori Havolli.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit i nderuar Kryeministër për këtë prezantim të detajuar, së pari për masat të cilat Qeveria e Kosovës në kapacitetet e veta ka pasur mundësi që ti përmbush gjatë kësaj kohe! Më vjen mirë që kjo tryezë për diskutim të mirëfilltë publiko-privat po mbahet me rregull, domethënë ka 3 muaj një afat kohor i këtij Këshilli për t'u takuar dhe për të dialoguar me sektorin privat. Dhe poashtu më vjen mirë që përkundër të gjitha sfidave që i kemi në këtë kohë të pandemisë, siç edhe ju informuam në fillim që kemi shumë pjesëmarrës që janë të infektuar, kanë gjetur zëvendësim për të vazhduar mbarëvajtjen e këtij takimi. Për të mos vazhduar më shumë, prezent kemi zv Ministrin e Financave z. Agim Krasniqi që do të i'a kaloj fjalën dhe më pas z. Muharrem Nitaj që është zv. Ministër i Ekonomisë dhe më pas vazhdojmë me prezantimet e tjera.

Agim Krasniqi (Ministria e Financave):

Faleminderit!

Përshëndetje Kryeministër, Ministra e zv. Ministra dhe të gjithë të pranishëm!

Shumë nga ato se çfarë mendova t'i them unë, një pjesë e tha Kryeministri, kështuqë nuk dua t'i përsëris. Ajo se çfarë mendoj është se ne si Ministri e Financave në këtë kohë krahas punëve të përditshme jemi duke u përgatitur të ballafaqohemi me dy probleme. Me pjesën shëndetësore, duke ndihmuar sektorin

e shëndetësisë dhe të ruajmë sektorin publik, duke mirëmbajtur nivelin e investime publike për aq sa kemi hapësirë, dhe në të njëjtën kohë së bashku me kabinetin qeveritar të shohim të gjitha mundësitë brenda këtyre kufizimeve që kemi të ndihmojmë edhe sektorin privat, ku duke ndihmuar sektorin privat, ne ndihmojmë ekonominë e vendit.

Që të mos përsëritemi, kjo periudhë na tregon që vlerësimet e para që kishim për një ulje prej 3.2% në PBB, tash vlerësimet e fundit janë që do të kemi rreth 6.7% rënie ekonomike për shkak të ndikimit negativ në investimet private por edhe ngecjes në implementim edhe të kësaj pjese që ka mbetur në investimet publike, e gjithë kjo si rezultat i pasigurisë dhe izolimit.

Të ju njoftoj për të dhënat e fundit që na tregojnë që në krahasim me projeksionet tona që kishim në rishikim, që do të kemi një rënie të të hyrave rreth 230 milionë, projeksionet e fundit tregojnë që këtë vit ne do ta mbyllim me rreth 320 milionë euro të hyra më pak për këtë vit.

Kjo do të reflektojë në mbylljen e këtij viti dhe në pjesën e mundësive që do t'i kemi në raport me implementimin e programit ose masave që i kemi paraparë.

Po e vërejmë që ky ndikim nuk do të jetë vetëm në vitin 2020, po flas për ndikimin negativ të COVID-19, por do të vazhdojë edhe në vitin 2021. Andaj edhe buxheti i vitit 2021 i ka marrë parasysh krejt këto elemente dhe është përgatitur, e që besoj brenda realitetit ekonomik, një buxhet prej 2.4 miliardëve. Është një buxhet real, me mundësi realizimi, dhe në kuadër të këtij buxheti, siç u potencua edhe nga Kryeministri, është paraparë edhe vazhdimi i programit për rimëkëmbje ekonomike prej 182 milionë eurove. Kemi mirëmbajtur investimet publike, gjithë që është shumë e rëndësishme edhe për sektorin privat, dhe brenda këtij programi kemi planifikuar që të kemi rreth 30 milionë euro për shëndetësi, ndërsa pjesa tjetër bashkë me kabinetin qeveritar, me oda dhe përfaqësues do të shiqohet se si do të ndahet.

Brenda programit të këtij viti për rimëkëmbje ekonomike prej 365 milionë eurove, janë ndarë deri tash 242 milionë dhe janë shpenzuar rreth 207 milionë, pjesa tjetër presim që ministritë e linjës mbi bazën e kritereve që janë aprovuar në qeveri, të paguhen ose të kryhen obligimet brenda këtij viti, në mënyrë që hapësira për diskutim për vitin e ardhshëm të jetë më efikase.

Realisht, mungesa e kalimit të ligjit për rimëkëmbje ekonomike, ne do të kemi më pak mundësi për të ndihmuar sektorin privat, rreth 100 milionë, të cilat mjete janë të parapara të vijnë prej AKP-së dhe siç tha Kryeministri, ne jemi duke përgatitur që së paku të ndihmojmë 2-3 sektorë, me vendimin e fundit, kryesisht sektorë që kanë pjesë e programit prej 290 eurove, më saktësisht, bizneset e vetëpunësuar. Po ashtu edhe dy sektorë të tjerë me rëndësi të veçantë për shkak se vendimi i fundit ku thotë të merret numri punëtorëve dhjetor, ka bërë që disa institucione dhe kufizimi prej 5% në rast se punëtorë ka pasur më pak, i ka atakuar këto veprimtari, kështu që presim që vendimi i fundit t'i mbulojë rreth 16,000 biznese. Diçka tjetër këtë vit nuk besoj se do të kemi mundësi të bëjmë për shkak se siç e ceka edhe më heret, të hyrat janë zvogëluar krahasim me projeksionet që kemi pasur prej 232 milionë, ne po shkojmë në 320 milionë.

Po mundohemi të bindim dhe të bashkëpunojmë me të gjitha organizatat buxhetore, që të realizojmë planin që e kanë për investime publike, sepse ajo do të ishte një ndihmë e drejtëpërdrejtë për sektorin privat në mënyrë që sado pak të rritet qarkullimi dhe të ketë rritje të likuiditetit të sektorit privat.

Pra, qëllimi për rimëkëmbje ekonomike është që të arrihet jo vetëm përmes politikave, ndihmës direkte por edhe përmes pjesës që ka të bëjë me të hyra, por kjo mvaret shumë prej kalimit të ligjit të rimëkëmbjes ekonomike.

Avdullah Hoti (Kryeministër):

Zv. Ministër nëse kisha mundur të ndërhyjë, Lindita kërkoj falje që po ndërhyjë!

Ju kisha lut edhe juve edhe ministrat tjerë që e marrin fjalën, përveq aktiviteteve të juaja që lidhen me pakon e rimëkëmbjes ekonomike, që t'i përmbledhni sa më shkurtër, nëse keni mundësi që t'i adresoni edhe qështjet që Sekretariati i ka listuar e që bien në fushë veprimtarinë e financave dhe ministrive të tjera. Këtë listë e keni marrë më heret, pra është lista e qështjeve që odat, shoqatat e ndryshme i kanë ngritur e që bien Brenda Ministrisë së Financave, e pastaj brenda fushës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Ministrisë së Tregtisë e kështu me rradhë. Pra zv. Ministër nëse e keni dokumentin përpara nëse keni mundësi t'i adresoni këto shkurtër në mënyrë që t'i lëmë hapësirë pastaj edhe ministrave të tjerë përpara se diskutimi të kaloj tek odat.

Agim Krasniqi (Ministria e Financave):

Në rregull, faleminderit Kryeministër! Mirëpo nuk e kam atë dokument dhe prandaj nuk mund të përgjigjem të gjithë atyre kërkesave për arsye që Ministria është paraparë të merr pjesë, mirëpo për shkak të situatës së saj shëndetësore jam unë këtu. Unë e kam bërë vetëm një prezantim të përgjithshëm, dhe një pjesë e kërkesave sigurisht tashmë do të adresohen me programin e ri që është planifikuar për vitin e ardhshëm. Pra, më vjen keq, mirëpo nuk i kam të listuara saktë këto obligime, mirëpo besoj që në fund do të mund t'i përgjigjem me shkrim kësaj pjese. Unë isha duke e përfunduar fjalimin tim për sot, andaj faleminderit!

Avdullah Hoti (Kryeministër):

Atëherë le të mbetet kështu, deri në fund të ditës ose nesër më së largu, të i'a dërgoni këto përgjigje për secilën qështje Linditës dhe Lindita kujdeset që t'i dërgojë tek të gjithë anëtarët e Këshillit.

Agim Krasniqi (Ministria e Financave):

Në rregull atëhere, sot ose nesër i dërgojmë.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit z. Kryeministër, faleminderit z. Krasniqi! Siç thamë edhe në fillim të takimit, për shkak të pandemisë kemi disa ndryshime në minutat e fundit dhe shpresoj që të mos ju pengoj protokollin në aspektin e renditjes. Tani do të i'a kalojmë fjalën z. Nitaj nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, duke i'u informuar se z. Nitaj është në zëvendësim të z. Kuçi i cili dje rezultoi pozitiv me Covid-19, kështuqë qështjet i ka të kyçura shumicën në prezantim, të cilat i kemi ngritur dhe fokusohen në energji dhe siç e kemi kërkuar në takimin e kaluar z. Kryeministër, në transformimin e ekonomisë apo energjisë në energji të gjelbër, si dhe disa veprime në aspekt të ankandit lidhur me energji, si dhe poashtu intervenimet që i kanë bërë në aspekt të portfolios për ndërmarrje të vogla, ndërmarrësi dhe inovacion. Faleminderit z. Nitaj, po ju kaloj fjalën.

Muharrem Nitaj (Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit)

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra dhe pjesëmarrës tjerë nga sektori privat,

Nga takimi i fundit që kemi pasur si Këshill Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë, mund të konsiderojmë që disa gjëra kanë lëvizur për mirë, por që kemi edhe gjëra që s'kanë lëvizur fare. Nuk

mund të shmangem në asnjë mënyrë që dora jonë e ndihmës drejt bizneseve lidhet me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike dhe nuk po shihet në horizont.

Unë po shfrytëzoj këtë rast dhe këtë këshill që të bëj thirrje brenda koalicionit, mirëpo edhe drejt gjithë politikës kosovare që duhet të kalojmë këtë ligj për rimëkëmbje.

Si Ministri e Ekonomisë dhe Ambientit, edhe pse domeni i fushave që mbulojmë është i gjerë, konsiderojmë që siguria e furnizimit me energji elektrike me kosto të përballueshme dhe në kohezion me mbrojtjen e mjedisit është baza e zhvillimit ekonomik. Mirëpo, nevojat e shfaqura sidomos nga pandemia COVID-19 kanë treguar se duhen krijuar kushtet e favorshme për digjitalizim të ekonomisë dhe zhvillim të ekonomisë së gjelbër.

Qeveria e Kosovës ka një program qeveritar që parasheh zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, që përbëhet nga komponenta ekonomike, sociale dhe komponenta ambientale. Në këtë linjë, Ekonomia e Gjelbër ka pasur fokusin e vet nga ne. Nëse shohim komponentët e Ekonomisë së Gjelbër, që janë: Ambienti, Energjia, Shëndeti dhe Ekonomia, angazhimi ynë ka qenë pothuajse i pandërprerë në këto fusha.

Ekuacioni mes Ekonomisë dhe Shëndetit nuk ka qenë i drejtë në këto kohë pandemie, pasi ruajtja e shëndetit në njërën anë, ka dëmtuar shëndetin ekonomik. Si Qeveri e Kosovës kemi dhuruar ndihmë ndaj bizneseve, aq sa na është dhënë hapësira ligjore.

Së fundi nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit janë ndarë 60 milionë euro për biznese për kostot operative të pagave, gjithashtu është plotësuar edhe me 1 milion euro buxheti për ndihmë ndaj ndërmarrjeve publike.

Në anën tjetër 1 milion euro që parashiheshin të ndaheshin si grante për ndërmarrjet private në kuadër të Ndërmarrësisë janë zhvendosur në çbllokim të situatës së rënduar financiare të Ndërmarrjes Publike "Trepça".

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë tashmë ka filluar punën në Grupin Punues për Ndërmarrësi, duke inkorporuar edhe qasjen e sektorit privat, pasi Ligji për Ndërmarrësi dhe Inovacion është në procedurë. Me këtë ritëm po punohet edhe në krijimin e Grupit Punues për Ekonomi të Gjelbër, si moment crucial për të transformuar ekonominë në një mënyrë tjetër funksionimi edhe me ndihmën e digjitalizimit.

Ajo në të cilën kemi pasur shumë punë ka qenë Energjia. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka qenë pjesë e shumë paneleve, takimeve dhe konferencave për Energjinë.

Zotimi i Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e burimeve mikse të energjisë, është një nga objektivat kryesore e reflektuar, në të gjitha dokumentet strategjike të sektorit përfshirë këtu Strategjinë aktuale të energjisë 2017-2026. Krejt kjo me qëllim të adresimit të sigurisë së furnizimit dhe optimizimit të burimeve nga qymyri, gazi dhe burimet e ripërtitshme.

Kosova është pajtuar që në bazë të studimit të parafizibilitetit të bërë nga MCC, të punoj në zhvillimin e rrjetit të gazit për projekt propozimet 1) Rrjeti i transmisionit të gazit dhe 2) Investimi në ndërtimin e rezervës sekondare dhe terciare dhe ndërtimin e një kapaciteti të vogël të gjenerimit gaz në energji elektrike. Gazin ne e shohim si komponent të rëndësishme në përdorimin e tij për industri si dhe ngrohje termike.

Dua të theksoj se zhvillimin e rrjetit të gazit duhet shikuar nga perspektiva regjionale me qenë se Kosova është treg i vogël. Prandaj, zhvillimi i konceptit regjional do të rriste efikasitetin ekonomik dhe do të ekonomizonte shfrytëzimin e tij.

Burimet e ripërtritshme janë një prioritet për qeverinë në kuadër të tranzicionit të energjisë. Deri në vitin 2030, në bazë edhe të obligimeve në raport me Bashkimin Evropian në presim që të instalojmë një kapacitet të ri rreth 600MW, kryesisht burime me diell dhe Erë. Totali i kapaciteteve të këtyre burimeve do të përcaktohet përmes Planit për Energji dhe Klime 2021-2030 si dhe me rishikimin e strategjisë aktuale të energjisë.

Në sot jemi duke punuar me BERZH në zhvillimin e procedurave konkurruese të tregut dhe një sistem të qëndrueshëm për ndërtimin e kapaciteteve të reja, me qëllim që të përmbushet targeti për burime të ripërtritshme. Ne po ashtu jemi duke punuar edhe me Komisionin Evropian, USAID, IFC dhe KFË në projekte të ngjashme të kësaj natyre dhe unë jam i bindur se në periudhën afatmesme do të kemi projektet e para të mëdha për nga kapaciteti të burimeve të ripërtritshme.

Tashmë janë bërë hapa konkretë në këtë zhvillim të procedurave për Ankand të Energjisë së Ripërtritshme, që shpresojmë ta bëjmë thirrjen e parë në Qershor të vitit 2021.

Në jemi të vetëdijshëm për ambientin e pafavorshëm në raport me qymyrin, qoftë nga perspektiva e financimit por edhe nga aspekti ambientit në raport me emetimet industriale.

Dua të rikujtoj se ne kemi filluar tranzicionin nga baza ku mbi 95% e gjenerimit ka qene nga qymyri, prandaj ideja se ne për një periudhë të shkurtër mund ta ndryshojmë këtë strukturë është jo reale dhe me një kosto shumë të lartë si për nga aspekti i sigurisë së furnizimit por edhe nga aspekti i tarifave dhe përballueshmërisë së çmimeve.

Me lejonin që të theksoj se qymyri për ne është edhe çështje socio-ekonomike, për faktin se sot në këtë sektor i kemi të punësuar mbi 5000 veta direkt dhe disa mijëra tjera indirekt, si dhe realizohen të hyra vjetore rreth 200 mil€.

Prandaj në funksion të diversifikimit të burimeve dhe qëndrueshmërisë në zhvillim të sektorit, ne jemi duke e rishikuar strategjinë e energjisë, dhe dua të theksoj se ky rishikim është duke iu nënshtuar katër kritereve kryesore:

- Sigurisë së furnizimit
- Opsionet me koston më të ulët
- Në harmoni me kërkesat ambientale, si dhe
- zhvillimin e një portfolio mikse të burimeve energjetike.

Këtë fjalë po e përmbyli me atë që edhe e fillova. Shpresoj që takimi tjetër i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime të na gjej me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike.

Ju falënderoj për vëmendjen tuaj dhe mbetem i hapur për diskutime!

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit shumë z. Nitaj për këtë prezantim! Çështjet që i kemi pasur në listë janë mbuluar plotësisht, mirëpo nëse ngriten nga diskutimet e sektorit privat, ne vazhdojmë punën siç kemi bërë zakonisht me Sekretariatit.

Me radhë e kemi Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, z. Vesel Krasniqi, i cili është bashkëpunorë i Sekretariatit, për shkak që kemi shumë fusha që ndërlidhen me sektorin privat, sidomos me portfolion e ndërmarrjeve të vogla e të mesme e që përbëjnë shumicën e bizneseve në Kosovë.

z. Krasniqi shpresoj që do të fokusohet edhe në pjesën e investimeve, poashtu agjencionit KIESA, si dhe atë të investimeve strategjike. Fjala për ju z. Krasniqi.

Vesel Krasniqi (Ministër i Tregtisë dhe Industrisë:

Përshëndetje Lindita, pëshëndetje për ju dhe stafin e juaj dhe faleminderit për punën që e keni bërë dhe jeni duke e bërë në këtë kohë pandemie dhe e meritoni një falënderim. Poashtu, dua të falenderoj, Kryeministrin, Ministrat, Zv. Ministrat, përfaqësuesit e odave ekonomike, të cilat janë një prej akterëve kryesorë të cilet me kontributin e tyre vazhdimisht kanë qenë zëri i bizneseve. Gjithashtu, dua të falenderoj dhe përshëndes Massimilianon, përfaqësuesin e Bankës Botërore i cili në vazhdimësi është në kontakt me ne dhe dikasteret përkatëse për implementimin e granteve që vijnë nga Banka Botërore. Unë sot do të fokusohem më shumë në atë që kemi bërë si MTI si përkrahje ndaj sektorit privat në këtë kohë pandemie si dhe në zbatimin e planit të aktiviteteve dhe kornizës legislative për këtë vit.

Fillimisht, në aspektin e rimëkëmbjes ekonomike, duke u bazuar në vendimin e qeverisë për *Planin për Zbatimin e Rimëkëmbjes Ekonomike*, si Ministri kemi filluar menjëherë punën në përpilimin e kushteve dhe hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit të Rimëkëmbjes.

Në përkrahje të drejtpërdrejt për sektorin privat, MTI në marrëveshjen me Bankën Botërore ka ndryshuar destinimin e **10.4 milionë eurove** gjatë dy viteve drejt investimeve të bizneseve në (1) teknologji; (2) makineri; dhe (3) standardizim.

Përveç kësaj, KIESA, në kuadër të MTI, ka realizuar grante në vlerë prej **600,000 euro** për bizneset private. **Nga 24 përfituesit, mbi 30% janë biznese në pronësi të grave.** Përveç kësaj, MTI gjithashtu ka realizuar grante në vlerë prej **1 milion euro** për bizneset e drejtuara nga gratë. Në vazhdimësi të fuqizimit ekonomik të grave, MTI planifikon të buxhetojë shumë prej rreth **400,000 euro** çdo vit për bizneset e grave.

Sa i përket sektorit të shërbimit në Kosovë, në kuadër të Planit për Rimëkëmbje, MTI ka planifikuar të realizojë mbështetje për ndërmarrjet e shërbimeve me anë të subvencioneve për sisteme softëare, konsulenca për marketing e për zhvillim të planeve të biznesit, mbështetje për menaxhim financiar dhe menaxhim të resurseve njerëzore, si dhe përkrahje për rritje, krijim të zingjirit të vlerës, certifikim të shërbimeve, dhe standardizim të ndërmarrjeve shërbyese.

Në kuadër të mbështetjes nga Komisioni Evropian, MTI ka lansuar projektin "**Asistencë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit - Direktiva e Shërbimeve të BE,**" në vlerë prej **1 milion euro**. Ky projekt, ka për qëllim zbatimin e direktivave të tregtisë në shërbime dhe do të implementohet nga konzorciumi Kroato-Gjerman, në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Sa i përket aktiviteteve tjera, Ministria ka mbledhur **Komisionin Ndërmarrësor për Investime Strategjike**, ku ka formuar dy **grupe operacionale për shqyrtimin e aplikimeve** të investitorëve potencial strategjikë, duke u bazuar në Ligjin për investime strategjike. Përveç kësaj, Ligji për Investime Strategjike, i cili ka afat të skadimit në fund të vitit 2020, është në proces të plotësim/ndryshimit.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Sekretariatit e KKEI, kemi filluar procedurat dhe takimet e grupit punues për plotësim-ndryshimin e **Ligjit për Investime të Huaja**, ligj ky i cili konsiderohet që ka nevojë për rishikim si nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ashtu edhe nga Ministria e Drejtësisë. Në kuadër të **Strategjisë për Mbështetje të Zhvillimit të Industrisë dhe Mjedisit Biznesor**, e cila është paraparë të finalizohet në nëntor 2021, janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Janë identifikuar anëtarët e grupit punues, që themelohet gjatë këtij muaji,
- Analiza e sektorëve të industrisë përpunuese është finalizuar nga ana e Departamentit të Industrisë,
- Janë identifikuar treguesit matës që do të jenë pjesë e strategjisë,
- Janë konsultuar dokumentet ekzistuese që ndërlidhen me industrinë përpunuese
- Janë kontaktuar donatorët potencial për asistencë teknike. Ende jemi në pritje të përgjigje nga Zyra për Planifikim Strategjik dhe UNDP.

Në aspektin e tregtisë, MTI është në proces të hartimit të kornizës ligjore për tregti, e cila përfshinë **Projektligjin për Tregti të Jashtme, Projektligjin për Tregti të Brendshme, si dhe Projektligjin për Tregti Elektronike.**

- Projektligji për Tregti të Jashtme rregullon tregtinë me jashtë në përputhshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke mbrojtur prodhuesit vendorë nga praktikat e padrejta të tregtisë ndërkombëtare dhe duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së popullit të Kosovës. Kosova tanimë është pjesë e tregut rajonal përmes marrëveshjes së CEFTA-së, pjesë e tregut të BE-së, përmes MSA-së si dhe synon që në të ardhmen të jetë pjesë e Organizatës Botërore të Tregtisë. Prandaj, hartimi i një ligji të ri do të ishte në përputhje me rregullat dhe parimet e OBT-së, MSA-së dhe CEFTA-së. Poashtu dua të cek që javë më parë kemi pasur një takim virtual që ka qenë takimi i parë i yni apo të themi hapi i parë për t'u anëtarësuar apo inkuadruar në organizatën e EFTA-s e të cilën e konsideroj që ka qenë një takim mjaftë produktiv.
- Projektligji për Tregti të Brendshme do të përcaktoj parimet dhe kushtet e përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në tregun e brendshëm të Republikës së Kosovës, ku do të përfshihet tregtia me pakicë në një ndërmarrje fikse; tregtia me pakicë në vendet publike; furnizimi me ushqime dhe pije; shitja e ushqimeve dhe pijeve për konsum në lokale pa shërbim në tavolinë; modalitetet e veçanta të tregtisë me pakicë dhe tregtia me shumicë duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së popullit të Kosovës. MTI ka pranuar një koncept notë nga USAID dhe është duke shqyrtuar dhe më pas do të vendoset për hapat e mëtejme. Ky projektligj ka kaluar procedurat e konsultimit publik.
- Poashtu, kemi inicuar në Qeveri për rend dite themelimin e Komisionit Ekzekutiv i cili javë më parë është miratuar nga Qeveria e Kosovës, i cili presim që këtë fundjavë ose javën tjetër, kryesuesi të thëret takimin e parë, dhe ta shqyrtojë dhe ta përmbysim këtë rekomandim i cili është rekomandim i BE.

MTI, në koordinim me Sekretariatën e KKEI dhe USAID do të vazhdojnë tutje me procedurat e bashkëpunimit për plotësim-ndryshimin dhe hartimin e kornizës ligjore për tregti.

Ju Faleminderit!

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit z. Vesel Krasniqi për këtë prezantim të detajuar, poashtu faleminderit edhe për bashkëpunimin për grupin punues.

Për të përmbysur diskutimin nga ana e ministrave, në fund kemi Ministrin e Bujqësisë z. Besian Mustafa të cilit i dëshirojmë rikthim të mirë në punë pasi që është shëruar nga virusi. Pastaj kemi edhe zv. Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe pastaj kalojmë tek diskutimet e odave.

z. Mustafa e keni fjalën.

Besian Mustafa (Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural):

Faleminderit shumë Linda! Përshëndetje Kryeministër, Ministra, zv. Ministra, pëshëndetje të gjithëve. Unë vetëm deshta shumë shpejtë, edhe me kërkesën e kryeministrit por edhe një pasqyrim të shpejtë të pagesave që kemi realizuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2020. Siç kam raportuar edhe në takimin e parë me fillimin e këtij mandati në muajin Shkurt të këtij viti, kemi gjetë mbi 25 milionë detyrime apo borxhe ndaj fermerëve përfitues të dy programeve thelbësore që ka Ministria, pra, programi granteve dhe programi i subvencioneve. Fillimisht kërkoj falje për zërin sepse ende nuk më është rehabilituar, kështu që shpresoj që po më dëgjoni mirë.

Sa i përket pagesave të granteve, sivjet kemi arritur të paguajmë grantet për 410 përfitues që kemi gjetur detyrime nga vitet 2018 dhe 2019, duke shfrytëzuar buxhetin e vitit 2020, në vlerë prej 13 milionë eurove. Pastaj kemi shlyer borxhet në vlerë prej 8.9 milionë euro të vitit 2019, për subvencionet e vitit 2019, duke shfrytëzuar buxhetin e vitit 2020 dhe nga viti 2020 kemi shfrytëzuar buxhetin për mbuluar shpenzimet e subvencioneve për vet programin e vitit 2020 për subvencione në vlerë prej 18,5 milionë euro. Pra, shumë shpejt, 27.4 milionë euro subvencione kemi paguar sivjet, 13 milionë euro grante, e gjithsej bëjnë 40,4 milionë euro që u kemi paguar bujqëve deri më tani, duke i shtuar kësaj edhe 2 milionë euro kompensim të 25% të vlerës së dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për periudhën Janar-Qershor. Pra gjithsej, kemi paguar 42,4 milionë grante dhe subvencione apo thënë në gjuhën e buxhetit, subvencione dhe transfere për fermerët, qoftë fermer individual, qoftë kompani në ushqim. Pra, 42,4 milionë euro, duke vazhduar edhe me pagesat e rregullta që do të vazhdojnë deri në fund të vitit për subvencion dhe për grante të vitit 2020, dhe natyrisht duke i shtuar këtu edhe dyfishimin e subvencioneve për vitin 2020, ku 12 milionë euro tanimë vetëm janë alokuar dhe do të vazhdojmë pagesën e të gjitha këtyre. Llogaritet që në kuadër të vitit 2020, me gjasë një pjesë e vogël do të mbesin edhe detyrime në 3 mujorin e parë të vitit 2021 për këtë pjesë të vitit 2020. Mirëpo gjithsej do të kemi 79 milionë euro grante dhe subvencione në kuadër të programit të vitit 2020, programi i granteve dhe subvencioneve për bujqësi dhe fermer. Po e përsëris pra edhe njëherë janë 79 milionë euro. Faleminderit Lindita, unë kaq kisha, vetëm një pasqyë të shpejtë të pagesave që kemi realizuar dhe që presim të realizojmë së shpejti.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit i nderuar ministër Mustafa, pasi që edhe në takimin e kaluar keni pasur një prezantim shumë të thukët të të gjitha masave të marra në sektorin e bujqësisë. Besoj që kjo si një ri-freskim ishte shumë e mirëseardhur dhe vazhdojmë bashkëpunimin e mirëfilltë me ju. Për përfundim nga ana e pjesës së diskutimeve të bllokut të parë e kemi prezent edhe z. Sokol Havolli, zv. Guvernator i BQK. Javën e kaluar janë dërguar poashtu edhe përmes Kryeministrit dhe Ministrisë së Financave rekomandimet e të gjithë odave ekonomike anëtare dhe partnere që i kemi, më lejoni që të theksoj se ne kemi 10 oda anëtare mirëpo jemi duke bashkëpunuar edhe me disa të tjera siç janë Shoqata e Bankave dhe Shoqata e Sigurimeve, të cilat ngrisin kërkesa të ndryshme të cilat i përkasin portfolios të BQK. Për më shumë detaje ftoj z. Havolli. Ju faleminderit!

Sokol Havolli (BQK):

Faleminderit shumë!

I nderuar Kryeministër Hoti, të nderuar ministra dhe përfaqësues të institucioneve,

Duke dashur të kursej kohën e pjesëmarrësve, po filloj drejtë me një përshkrim të një komponenteje kryesore të sektorit bankar që ka të bëjë me rimëkëmbjen ekonomike apo me financimin e aktivitetit në vend, pra do të diskutoj shkurtër për kreditimin.

Duhet të theksojmë se edhe gjatë vitit 2020, kreditimi ka vazhduar me ritme të mira, duke përjashtuar periudhën kur kemi qenë në mbyllje në nivel më të lartë dhe niveli i kredive aktualisht është në 3.2 miliardë euro në nivel vendi, që paraqet një rritje vjetore prej 7.6%. Ndërsa vlera e kredive e lëshuar vetëm gjatë 3 mujorit të fundit, në periudhën Korrik-Shtator, është 486 milionë euro. Pra, kredi të reja, që paraqet një rritje vjetore prej 30%, një rritje mjaftë fuqishme. Rritjen e kreditimit padyshim e kanë mundësuar edhe masat e ndërmara nga BQK që kanë pasur për qëllim lehtësimin e barrës së pagesës së borxheve për huamarrësit poashtu edhe duke lehtësuar kërkesat rregullatore.

Megjithatë duke marrë parasysh se pandemia është duke vazhduar edhe më tutje dhe efektet negative mund të zgjasin edhe më tutje, si Bankë Qendrore jemi të pëkushtuar që të ndëmarrim masa të reja me qëllim të mbështetjes së aktivitetit ekonomik në vend.

Për një varg prej këtyre masave, e falënderojmë edhe Kryeministrin Hoti dhe Ministren Bajrami për vizitën në Bankën Qendrore, vetëm se i kemi diskutuar me Qeverinë gjatë vizitës së tyre në Bankën Qendrore, mirëpo është edhe një varg tjetër i masave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë financim të qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik në vend. Masa këto të cilat janë poashtu të rekomanduara edhe nga FMN por që janë marrë edhe nga Banka Qendrore Evropiane.

Pra qëllimi i Bankës Qendrore është që në një periudhë afatshkurtër të ulë nivelin e kërkesës për kapital në sektorin bankar nga 12% në 10% me qëllim që sistemi bankar të vazhdojë të ketë kapacitete të mjaftueshme për të kredituar ekonominë. Duhet ta theksojmë se për sa i përket stabilitetit të sektorit financiar, sektori financiar në përgjithësi ka qenë në ditët më të mira të tij në kohën kur kemi hyrë në pandemi dhe deri tash efektet negative natyrisht se janë ndjerë në secilin segment, përfshirë edhe sektorin financiar në vend. Por, çfarë është edhe më e rëndësishmja është se jemi të sigurt në stabilitetin e sektorit bankar por po ashtu jemi të sigurt edhe në kapacitetin e sektorit bankar për të financuar aktivitetin ekonomik në vend.

Kontributi edhe më tutje i sektorit bankar do të rritet, sidomos pas kalimit të ligjit për rimëkëmbje, këtë duke përfshirë edhe pikat e ngritura nga sektori privat, duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e pakos së rimëkëmbjes bazohet në masat e lehtësimit për qasje në financa.

Subvencionimi i normave të interesit dhe garantimi i kredive pritet të ketë rol substancial në rritjen e financimit kreditor në ekonomi. Sidoqoftë, duhet ta kemi parasysh se në skemat e mbështetjes t'i bëjmë sa më efektive duke përcaktuar edhe kriteret kualifikuese për përfituesit eventual.

Me këtë duhet të kemi parasysh faktin se pozita financiare e një pjese të konsiderueshme të bizneseve dhe individëve është prekur negativisht nga kriza, por kjo nuk duhet t'i përjashtojë ata nga përfitimi i lehtësimit të qasjes në financa, për shkak se mund të jenë të kategorizuar edhe si kredimarrës jo të mirë. Pra, nëse Fondi për Garanci Kreditore do të pranonte vetëm garantimin e kredive të klientëve që nuk kanë pasur ndonjë problem për kthimin e kredisë, atëherë do të përfundonim duke përkrahur klientët të cilët edhe pa një skemë të tillë do të mund të siguronin qasje në kredi. Prandaj duhet ta kemi parasysh që në një përkeqësim eventual si rezultat i pandemisë, të merret parasysh situatë lehtësuese.

Kjo ka qenë edhe njëra nga shqetësimet e ngritura nga Kryeministri Hoti gjatë vizitës në Bankë Qendrore, dhe ne në Bankë Qendrore jemi duke punuar që të krijojmë një mekanizëm i cili e bënë më të lehtë klasifikimin e kredimarrësve që kanë pasur probleme si rezultat i pandemisë dhe ta bëjmë dallimin me kredimarrësit e tjerë të cilët kanë pasur vonesa apo problem për arsye tjera e jo për shkak të pandemisë. Në çështjet e diskutuara me Kryeministrin Hoti dhe Ministren Bajrami, aktualisht në Bankën Qendrore jemi duke punuar në formatin e ri të raportimit për sa i përket klasifikimit. Ndërsa disa nga çështjet e ngritura nga Oda e Afarizmit të Kosovës, konsiderojmë se do të jenë të adresuara nëse e marrim parasysh faktin se Fondi për Garanci Kreditore pritet të rrisë nivelin e mbulueshmërisë apo garancionit në 80%, pra që lidhet drejtëpërdrejtë me pikën e parë, dhe poashtu kjo nuk kufizon edhe llojin e biznesit të cilin do të mbulojë. Pikën e tretë, vetëm nëse e bëjmë qështjen e klasifikimit, kjo automatikisht do të mundësojë edhe riprogramimet eventuale, dhe klasifikimi nëse ndodhë për shkak të pandemisë do të ketë efektin tjetër, dhe gjithashtu edhe pikat tjera të ngritura nga Oda e Afarizmit si përshebull "Dhënia e kredive për bizneset e reja", atëherë shfrytëzimi eventual i FGK natyrisht se do të krijojë siguri të mjaftueshme për sektorin bankar që të rrisë kreditimin e tij për sektorin privat. Ndërsa BQK poashtu shpreh përkushtimin e saj që do të mbetet e hapur që për të gjitha kapacitetet e saj profesionale të përkrahë politikat e përgjithshme dhe të mbështet zhvillimin ekonomik në vend dhe ashtu siç e kemi premtuar edhe gjatë takimit të javëve të kaluara me Kryeministrin Hoti dhe me Ministren Bajrami, ne

do të kontribuojmë edhe në fazën e zbatimit duke e bërë sektorin financiar si njëri prej mekanizmave kryesorë për rikthimin e zhvillimit ekonomik në vend.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Ju faleminderit z. Havolli për prezantimin nga ana e BQK, mund të them që në takimin e kaluar Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Amerikane kanë qenë poashtu prezantuese të masave që janë kërkuar edhe nga Banka Qendrore e që kryesisht janë lidhur me kreditimin e ekonomisë siç është rritja e kapitalit të FGK si dhe subvencionimi i normave të interesit në shuma më të larta siç e kanë cekur në kërkesë si “shuma mbi 150 milionë”. Po besoj që të gjitha kërkesat e odave përfshirë edhe ato partnere siç i përmenda edhe më lartë, Shoqata e Bankave dhe Shoqata e Sigurimeve, kanë dërguar kërkesa tek ne, e të cilat ne i kemi përcjellur në një dokument përmbledhës.

Për sqarimin shtesë, para se të kalojmë tek pjesa e diskutimeve të odave, Sekretariati, si zakonisht përgatit një notë përmbledhëse, meqënëse kemi tejkaluar kohën, po fokusohem në pikat kyçe.

Është e dukshme që rënia ekonomisë është më keq se që është paraparë në tre mujorin e parë, sipas BQK me 7.2% me parashikimet më të fundit, me 6 deri në 7.5% sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe parashikimet pak më të zymëta i kemi nga Banka Botërore e cila i parasheh me 8.8%.

Por, të gjitha këto si prezantime për rimëkëmbje mund të them që ndoshta kur vjen viti 2021 do të kemi një rikthim më të mirë në aspektin e pandemisë, duke pasur parasysh që kemi lajme pozitive për sa i përket zhvillimit të vaksinave dhe besojmë që viti financiar 2021 pret një rritje prej 4 deri në 6%.

Sekretariati duke i përmbledhur pikat kyçe që është fokusuar edhe përmes ligjit të rimëkëmbjes ku edhe ka dërguar komente, por edhe në transformim të ekonomisë, është fokusuar në disa pika kyçe për të cilat nuk do të marrë shumë kohë.

Ndër kërkesat kyçe të sektorit privat e të përkrahura edhe nga ana e Sekretariatit janë:

- Plotësim-ndryshimi i ligjit për prokurim publik
- Politikat fiskale si mjet i stimulimit të sektorëve me potencial, dmth këtu janë përfshirë edhe pushimet tatimore për investitorë të huaj përfshirë edhe ata nga diaspora, për 3 deri në 7 vite
- Korniza legjislative në përkrahje të eksportit duke pasur parasysh që gjatë kësaj kohe kemi pasur sfida edhe në qarkullim të mallërave, përveq njerëzve.
- Në politikat fiskale si mjet i stimulimit të sektorëve me potencial: lirimi nga detyrimet e ndryshme doganore dhe tatimore në mallëra të caktuara dhe në lëndë të parë, politikë e cila direkt apo indirekt do të rriste prodhimin apo rimbursimin e TVSH-së së zbritshme si dhe përshtetimi i procedurave për rimbursim.

Sa i përket rimëkëmbjes ekonomike, unë besoj se duke pasur parasysh vonesën në aprovimin e ligjit, besoj që Qeveria e Kosovës duhet të bëjë gati një plan B që të shoh si mund t'i përmbush këto masa përmes rrugëve të tjera që ekzistojnë. Poashtu, kemi theksuar edhe projektligjin për inspektime, i cili është në draft të fundit, ligji ky i cili do të ndihmonte shumë në rritjen e monitorimit të performancës dhe të bizneseve dhe do të ndihmonte edhe në ritjen e mirëfilltë të bizneseve të shëndosha në treg.

Këto ishin disa nga rekomandimet kyçe që janë prezantuar dhe janë përkrahur në notën përmbledhëse të sekretariatit që i kemi dërguar, për më shumë ne do të vazhdojmë punën siç u prezantua nga 3 ministrinë deri tani, domethënë me grupet punuese për Ligjin për Investime me iniciativë të MD dhe MTI në Investime të Huaja Direkte, në Ligjin për Ndëmarësi dhe Inovacion përmes Ministrisë së Ekonomisë, dhe në grupin punues konsultativë që do ta bëjmë në ndikimin e punësimit me MPMS apo Agjencinë e Punësimit. Këto janë grupet në të cilat i presim odat në bashkëpunim me stafin teknik dhe politik të Ministrive të bashkëpunojmë dhe kontribuojmë për këto masa specifike.

Përfundimisht kemi arritur tek pjesa e diskutimeve të odave, ku do të i'a kaloj fjalën Kryetarit të Odës së Afarizmit të Kosovës, z. Skender Krasniqi, pasi në takimin e kaluar patëm një prezantim të thukët nga Oda Ekonomike e Kosovës, poashtu nga Oda Amerikane, Oda Gjermane e AKB.

Skender Krasniqi (OAK):

Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) në kuadër të takimeve të vazhdueshme që ka me institucionet relevante ka përgatitur dhe është duke përcjellur në vazhdimësi rekomandimet e saj në mënyrë që të përkrahet sektori privat, në tejkalimin e krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia globale Covid 19. Situata e shkaktuar në vend si pasojë e pandemisë ka bërë që sektori privat të mbetet më i godituri e ndër të cilët janë edhe prodhuesit vendor. Në këtë takim fokusi ynë është tek prodhuesit vendor, të cilët konsiderojmë që duhet të përkrahen dhe stimulohen në mënyrë që të përballojnë efektet e pandemisë. Duke e marrë parasysh gjendjen e rëndë në të cilën jemi, OAK ripërsërit kërkesën që të largohet ora policore dhe kufizimet në orar dhe të shtohen masat gjatë 24 orëve.

Arsyeja qëndron se gjatë gjithë ditës jemi duke parë qarkullim masiv të qytetarëve në shitore, rrugë dhe kafene ku nuk është duke u respektuar pothuajse asnjë rregull si numri i kufizuar në bazë të metrave katrore në një shitore apo market, numri i kufizuar në lokale dhe largësia 2 metra nga tavolina apo numri maksimal prej 5 personave që lejohen të jenë në një tavolinë.

Rekomandim i OAK-së: të rriten masat, të zbatohen rregullat 24 orë, të hiqen kufizimet e qarkullimit.

OAK Në kuadër të ligjit për rimëkëmbjen ekonomike ka kërkuar dhe po kërkon që të përfshihen edhe këto kërkesa:

- Lënda e parë të trajtohet njësoj sikurse që lirohet kur blihet jashtë vendit, të veprohet njëjtë edhe në rastet e blerjes brenda vendit (Lirimi nga tvsh);
- Të rritet fondi për garanci kreditore në 300 milionë euro;
- Të ulet norma e interesit nga BQK në 1.7 %; ne menyre qe te ulen normat e interesit nga bankat komerciale.
- Të ulet Tvsh në ushqim, turizëm dhe hotelieri në 5%;

Përkrahja për prodhuesit përfshinë:

- Krijimi i arkës "PATRIOT", ku çdo produkt vendor të subvencionohet në dalje (në market) me 10 % ulje dhe te subvencionohet eksporti i prodhimeve me 10%

Me këtë dhe gjatë kësaj kohe dhe si masë e përkohshme do të ndihmohen prodhuesit vendorë dhe nxiten investimet në rritje të eksportit.

Për njohuri të juaja Kosova nga viti 2015 deri në 2019, për 5 vite edhe pas hyrjes në MSA e ka rritur exportin për vetëm 58 milion € në vit ndërsa importi ka vazhduar në rritje enorme për mbi 1 miliard EURO në vit. Eshte llogarit që do të ketë efekt pozitiv si CEFTA ashtu edhe MSA por realiteti është i kundërt.

Për njoftim:

Shqipëria gjatë këtyre viteve ka rritur exportin për 500 milion € në vit ndërsa importin për 1 miliard € në vit, ndërsa Maqedonia gjatë këtyre 5 viteve ka rritur exportin per 2.6 miliard € në vit ndërsa importin për 2.3 miliard € në vit, pra ka arritur që të ketë export më të lartë se importi.

Kërkesa të tjera:

1. Ligji për investime strategjike të trajtohet me prioritet. Sipas informacioneve nga MTI aktualisht janë në pritje mbi 1 miliardë euro investime për të kaluar dhe përfituar statusin e investitorit strategjik. I kemi edhe 2 investitorë të cilët tashmë i kanë kaluar të gjitha fazat dhe presin të futen në rendin e ditës në Qeveri për votim dhe fillim të investimit të kapitalit të tyre.
2. Të zgjidhen problemet që bizneset po kanë gjatë tranzitit me Serbinë ku biznesi po detyrohet që në vendin e importit të mallit psh në Gjermani të pajisen me dy certifikata fitosanitare, një me Republika e Kosovës për hyrje në Kosovë dhe një me Kosovo i Metohija për të qarkulluar transit nëpër Serbi.
3. Kërkesat për BQK
 - Të rikthehet në gjendjen e mëparshme Udhëzimi mbi Implementimin e Sistemit Bonus – Malus për Persona Juridik, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Byrosë Kosovare të Sigurimeve lidhur me regjistrimin e veturave dhe i futur në fuqi me 1 nëntor.
 - Të largohet kamata prej 5-8 % për kthimin e parave metalike në kartmonedha, detyrim i vendosur nga BQK;
 - Të ulen tarifat e shfrytëzimit të posave nga ana e bizneseve nga 1-3% sa është aktualisht në së paku 0.25%.

Si përfundim kërkojmë edhe njëherë nga z. Kryeministër Hoti që në këtë kohë të rendë ti shtyni këto kërkesa të bizneseve përpara në mënyrë që të kemi rënie më të vogël dhe të mund të rimëkëmbemi pas kalimit të pandemisë e cila do të jetë prezente së paku edhe 6 muaj. Si segment pozitiv gjatë kësaj kohe pandemie mund të marrim rritjen e shfrytëzimit dhe shërbimit të teknologjisë informative e cila është duke ndikuar drejtpërsëdrejti edhe te fëmijet tonë duke u mësuar që të shfrytëzojnë Teknologjinë. Si rast konkret është e-mësimi. Pra, është e mundur që edhe kur jemi të vendosur në pozita të vështira të paktën të mundohemi ti shfrytëzojmë për të mirë ato mundësi që na jipen.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit i nderuar z. Skender! KKEI, siç e dini e kemi ndërruar edhe emrin, dhe si Sekretariat ju falenderojmë për bashkëpunimin e afërt, dhe gjithëmonë të bashkangjitur me fakte dhe dokumentet mbështetëse.

Tash me rradhë i'a kalojmë fjalën znj. Linda Shala e cila kësaj rradhe do të flasë për ndihmat dhe masat që janë ndërmarrë për një nga kategoritë më të ndjeshme e që janë bizneset e grave.

Linda Shala G7:

Përshendetje të gjithëve!

Kërkesa e Dhomës Ekonomike të Grave dhe besoj e të gjithë Asociacioneve të Biznesit është të bëhet një mobilizim më i madhë, në mënyrë që sa më shpejtë të kalon Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike. Së dyti dëshiroj të falenderoj për realizimin e kërkesës së tyre nga ana e Agjencionit për Barazi Gjinore, ku një sektor shumë i rëndësishëm i çerdheve apo kopshteve private, siç e përmendi dhe Kryeministri, shumë shpejt brenda javës tjetër do të pranojnë mbështetjen e parë monetare, gjë shumë e rëndësishme për to. Po ashtu kemi një vlerësim të mire nga ana e bizneseve që kanë përfituar ku shumica prej tyre janë biznese të grave, jo vetëm për shkak të përfitimit material, por edhe besimit se me të vërtetë do të ketë mënyra dhe mundësi që shtetit t'i del në ndihmë bizneseve që kanë pësuar nga pandemia. Unë tutje ngris tre çështje: 1. Në kuadër të qasjes në financa të formohet një komision brenda Fondit për Garanci Kreditore që do asistojë bizneset në raport me bankat, kur ato fillojnë të aplikojnë për marrjen e kredive të ndryshme e ku Fondi ka me qenë pale, sepse nga përvoja e kaluar e bizneseve me bankat sidomos gjatë pandemisë, në shtyerjen e kredisë, situatë reale qëndron në atë se shumica e bizneseve nuk kanë njohurit profesionale për bankat dhe produktet e tyre. Po ashtu, të ekzistojë edhe një kontroll nga Banka Qendrore në mënyrë që bizneset të dijnë qartë dhe saktë se në çfarë aranzhmane po hyjnë me banka në mënyrë që të mos paraqitet një situatë na është paraqitur, ku mund të ketë të themi një keqpërdorim nga ana e bankave si tek rasti i shtyerjes së kredive, sidomos kur ato hyjnë në marrëveshje kontraktuale ku paraqitet edhe Fondi për Garanci Kreditore. Domethënë, të ketë një monitorim të bankave në realizimin e marrëveshjeve me bizneset; 2. Besojmë se do të ketë një trajtim të bizneseve të regjistruara në ARBK si të vetëpunësuar, sikurse edhe u trajtuan edhe çerdhet dhe kopshtet private. Relativisht është një numër i vogël i tyre, është shumë i ndjeshëm, si dhe kryesisht janë biznese të grave, prandaj mundësisht të gjendet buxhet që në mënyrë të drejtëpërdrejt t'i ndihmohet atyre bizneseve, duke pasur parasysh që janë anashkaluar edhe me pakon emergjente, pasi që vonë kanë hyrë në sistem, por edhe me pakon e 60 milionshit, sepse realisht ato nuk kanë të deklaruar të punësuar. Sa kemi kuptuar ka iniciativë dhe besojmë që mund të bëhet, sepse besojmë që fondi për ndihmë këtyre bizneseve nuk ka me qenë i naltë, dhe 3. Në kuadër të Fondit për Garanci Kreditore, në emër të shoqatës STIKK, kërkojmë të hapet një dritare e veçantë me emërtimin Inovacion, për mbështetje të bizneseve Start Up, të bizneseve të reja të IT-së si sektor me potencial zhvillimi dhe i cili besojmë se ka prespektiv të madhe, duke pasur parasysh që gjatë pandemisë puna online dhe digjitale është në rritje e sipër. Kisha pas dëshirë që në mbledhjet e ardhshme të KKEI-së të kemi përgjigje konkrete lidhur me atë se çfarë mund të bëhet dhe çfarë jo, në mënyrë që edhe ne me biznese të mos insitojmë në kërkesa të cilat nuk mund të realizohet. Të jemi të qartë të shtyejmë proceset ku mund të bëjmë diçka, ku nuk ka kufizime ligjore dhe kufizime nga organizatat ndërkombëtare të cilat mbështesin projektet e rimëkëmbjes dhe ato të fuqizimit të ekonomisë së Kosovës.

Lindita Daija:

Faleminderit shumë Linda! Siç e përmendet, shumë nga kërkesat sipas mundësive janë përmbushur nëpërmjet buxhetit të Qeverisë dhe kanë mbetur po aq shumë të cilat janë pjesë e ligjit të rimëkëmbjes ekonomike i cili ende nuk është aprovuar. Dua të shfrytëzojë rastin, meqë kemi një apo dy oda të cilat do të donin të diskutonin, meqë në takimet e kaluara kemi pasur një kohë të gjatë të prezantimit të odave, domethënë z. Milazim Abazi dhe znj. Lumnije Ajdini kanë dëshiruar ta marrin fjalën. Poashtu dua të i'u

informoj që kemi prezent edhe partnerët tonë ndërkombëtarë, z. Neil Taylor nga BERZH-i, z. Massimiliano Paolucci nga Banka Botërore, z. Vadim Deleu nga Komisioni Evropian, z. Pozhegu nga Ambasada Amerikane dhe znj. Dardane Peja nga USAID, poashtu kemi edhe drejtuesit e KIESA, Doganave dhe ATK. Po i'a kaloj fjalën znj. Arieta Pozhegu e cila dëshiron shumë shkurtë të potencoj diçka.

Arieta Vula Pozhegu SHPK:

Përshëndetje!

Meqë jemi këtu të gjithë së bashku, kërkoj që në mbledhjen e radhës, kur të diskutohet për pakon e rimëkëmbjes ekonomike, të jenë të pranishme odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit në Kuvend, dhe secili nga ne, përfaqësuesit ta marrin fjalën fillimisht. Të gjithë nga ne diskutojmë dhe flasim nëpër media, mirëpo siç shihet asgjë nuk ka ndodhë. Ne si shoqëri civile, organizata dhe shoqata biznesi duhet të kemi zë më të fuqishëm në këtë drejtim, ngase ne jemi shumë vonë me pako, krahasuar me shtetet tjera. Mendoj që të gjithë pajtohemi në këtë pike të marrim pjesë në Kuvend dhe secili nga ne të kemi disa minuta në dispozicion me qëllim që të shprehim gjendjen e sektorit apo grupit të cilin e përfaqëson dhe të shohim se kush voton ose jo. Edhe ne si shoqëri civile përfaqësojmë grupe të caktuara, dhe ne mbajmë përgjegjësi për këto që po ndodhin.

Lindita Daija:

Faleminderit Arieta për këtë kërkesë! Sekretariati vec se ka filluar ta shiqoj dhe analizojë këtë iniciativë, në mënyrë që të organizohet një takim me odat dhe asociacionet e bizneseve, të paktën me Komisionin Ekonomik, nëse jo me të gjithë Kuvendin. Ne do të vazhdojmë me këtë iniciativë dhe do të ju mbajmë të informuar, sidoqoftë, faleminderit!

Znj. Lumnije Hajdini nëse doni ta merrni fjalën!

Lumnije Hajdini AKB:

I nderuar Kryeminister, të nderuar ministra, përfaqësues të Bankës Botërore, Komisionit Evropian, USAID, Ambasades Amerikane, BERZH-it dhe gjithë kolegëve nga odat ekonomike. Ne si Aleancë e Biznesit nga 14 mars kur ka filluar pandemia, kemi qenë gjatë gjithë kohës me përfaqësues qoftë të qeverisë qoftë të kuvendit të Kosovës, në takime të përditshme. Kjo çfarë po na ndodhë nuk është e lehtë, e përmendi edhe kolegja ime Arieta, mos aprovimi i ligjit për rimëkëmbje nga ana e deputetëve në Kuvendin e Kosovës, ka qenë shokuese për sektorin privat, sepse ata po marrin paga e sektori privat është në gjendje të mjerueshme. Desha të falenderoj Kryeministrin dhe Ministren e Financave, sepse po i informoj të gjithë kolegët që është hequr akciza për pijet jo alkoolike, një taksë që ka rënduar sektorin e pijeve joalkoolike në Kosovë, mandej jemi duke bërë promovimin e prodhimeve vendore, edhe pse në kohë pandemie ne po mundohemi që të vazhdojmë me traditën 18 vjeqare e promovimit të tyre, mirepo për shkak të pandemisë dhe masave anti-covid, ne kemi realizuar aktivitete tek eksportuesit e Kosovës në ato vende që nuk e kanë njohur Kosovën, si dhe në vendet e Bashkësisë Evropiane ku kemi bashkëpunim dhe miqësi të mire. Sa i përket eksportit, subvencionimit të eksportit, ne e dijmë që në ligjin për rimëkëmbje ekonomike janë masat e parapara që i kemi punuar bashkarisht edhe ne si përfaqësues të Aleancës, odave me kolegët e mi kemi që kemi qenë në bashkëpunim me Kryeministrin gjatë gjithë kohës edhe për hartimin e masave të cilat i kanë marrë parasysh dhe po e shohim se çfarë po ndodhë. Mirëpo, ne duhet të fokusohemi në atë se çfarë kemi mundësi të bëjmë si komunitet i bizneseve dhe si qeveri, sepse tani

për tani në Kuvend nuk po funksionon. Desha të informoj se ne si AKB kemi takime të përditshme me të gjitha grupet, komisionet parlamentare dhe me deputet. Ju themi sinqerisht se bizneset e Kosovës janë lodhur dhe kemi bërë kërkesë të marrim pjesë në seance të gjitha odat dhe të jemi pjesë e takimeve të tyre, të shohim si po reagojnë, edhe pse po shohim që qendrimi i tyre nuk po ndryshon. Mirëpo kisha kërkuar nga Kryeministri, siç e bëri tash për 60 milion euro që i dha ndihmë direkte, edhe përveç ndihmave tjera nëpër ministritë domene, kisha sugjeruar që Kryeministri mund ta bëjë tash, sepse është në domenin e Ministrisë së Financave, u përmendë edhe nga kolegët e tjerë, lirimi nga taksa për lëndën e pare. Me ligjin për lirim nga taksa doganore është një nen që parasheh Ministri i Financave ka të drejtë të shtojë listen e produkteve për lirim nga taksa doganore, mirëpo me aprovim nga ana e kabinetit qeveritar. Edhe këtë besoj që KM do ta bëjë shumë shpejt. Sa i përket subvencionimit të eksporteve, edhe ne kemi kërkuar duke ditur se në çfarë gjendje kemi eksportuesit tanë, me guvernatorin e BQK-së kemi realizuar shumë takime, nuk jemi të kënaqur se bankat komerciale e kanë shfrytëzuar edhe situatën, edhe pse po thirren se kanë lëshuar kredi të reja nuk është e vërtetë, sepse nën një kanë bërë riprogramim të kredive dhe nën dy mandej kur është bërë shtyerja e kredive, për bizneset e mëdha që kanë kredi mbi 1 milion euro iu është dashur të paguajnë këstin prej mbi 27000 euro që ka qenë e pamundur të ipet në atë kohë. Tani ka shumë modalitete që ne mundemi bashkarisht dhe ne si AKB do të vazhdojmë bashkëpunimin dhe do jemi përkrah me qeverinë, të cilën e falenderoj edhe një here pasi që të Qeveria, Kryeministri dhe të gjithë ministrat e kanë bërë punën e vet, mirëpo ne po na stopojnë deputet tone, dhe ju kisha lutur kolegëve që të kenë takime të rregullta edhe në media për atë që ligji për rimëkëmbje është i vonuar. Kryeministri e përmendi se në pjesën e parë të dhjetorit do ta ketë takimin me donatorë ku do të ketë mundësi të llojë dhe të kemi disa masa që zbatohen, sepse shpresoj në aprovimin e ligjit për rimëkëmbje edhe pse të them të drejtën nuk kam shumë shpresa që do të aprovohet këto dy javë. E nderuara Lindita kisha dashur të shtoj që në pjesën e rekomandimeve ta largoni pikën e kërkuar “heqja e akcizës për pije joalkoolike dhe makineri transportuese” pasi ajo është realizuar si rekomandim nga Ministria e Financave dhe Kryeministri. Ndërsa për rekomandimet tjera do të jemi në bashkëpunim gjatë gjithë kohës me ju. Edhe për Ministrin Veseli kisha dashur shumë shkurt të di se ku ma mbetur procesi për Ligjin për tregti të brendshme dhe e dyta në cilësinë e anëtarës së Këshillit Ekonomiko Social po ju informoj se kemi punuar për dy çështje për pagën minimale dhe për marrëveshjen e përgjithshme kolektive, mirëpo për shkak të situatës së pandemisë e kemi lënë që të vazhdojmë diskutojmë javën e ardhshme, sepse paga minimale nuk është rritur që nga viti 2011 dhe e kemi shkel pak a shumë ligjin dhe komisioni për ekonomi ka hartuar një modalitet dhe do ju informojmë për çfarëdo që keni nevojë.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Për fund kemi z. Milazim Abazi nga Oda Amerikane dhe pastaj z. Vadim Deleu. Fjalën po i'a kaloj z. Vadim Deleu!

Vadim Deleu (Përfaqësues i zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë):

Mirëdita të gjithëve, përfaqësuesve të institucioneve, organizatave të bizneseve të Kosovës. Ndoshta, vetëm shkurtimisht një koment sa i përket anës tonë. Mirëpresim organizimin e takimeve të rregullta në mes të asociacioneve të bizneseve dhe institucioneve të Kosovës, për të rritur dialogun publiku privat nëpërmjet KKEI-së ka qenë një ndër rekomandimet e cekura në Raportin e Kosovës që është publikuar muajin e kaluar, që i përket zhvillimit të politikës industriale dhe politikës së NVM në Kosovë.

Siç e dini është duke u punuar në zbatimin e masave konkrete dhe konkluzioneve që rrjedhin nga marrëveshja e asociimit e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe po ashtu nga vlerësimi i projektit të reformave ekonomike. Në këtë drejtim unë përpiqem të sjell faktin se javën e kaluar kishim një takim virtual të përfaqësuesve të Komisionit Evropian, me qëllim të bëjnë vlerësimin paraprak të projektit për reformat ekonomike, çështje që pak a shumë kanë të bëjë me substancën e diskutimeve lidhur me kornizimin e politikës së rimëkëmbjes socio-ekonomike në Kosovë. Unë sigurisht e di për mbështetjen e madhe të EU-së drejtë rimëkëmbjes socio ekonomike në Kosovë, përmes kredive dhe granteve në shumë prej rreth 170 milion euro. Unë nuk do e elaboroja në veçanti këtu, por ekzistojnë edhe disa masa të veçanta për mbështetjen e sektorit privat (bizneseve), në këtë drejtim është me rëndësi të theksohet se aktualisht në bashkëpunim me kolegët e ZKM-në , departmaneti i zhvillimit të ndihmës, ja po e shoh edhe Z. Canollin këtu veçanërisht i përfshirë në diskutimet lidhur me ushtrimin e programit IPA III, mendoj që është me rëndësi të kihet parasysh se ne do mirëpresim përpjekjet për formulimin e atyre politikave, si dhe përpjekjet për implementimin e tyre për rimëkëmbjen socio-ekonomike janë duke u bërë duke marrë parasysh gjithashtu edhe rekomandimet e ndryshme të dhëna nga zyra e BE-së në javët dhe muajt e fundit. Kështu që në mirëpresim diskutimet frytdhënëse dhe bashkëpunimin në këtë kuadër.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit shumë z. Deleu, faleminderit shumë për mbështetjen që Komisioni Evropian i ka dhënë Kosovës gjatë periudhës së pandemisë.

Më tutje, do të i'a kaloja fjalën koleges znj. Dardane Peja nga USAID e cila është përgjegjëse për portfolion ekonomike.

Dardane Peja USAID:

Vetëm desha të sqaroj lidhur me projektligjin për tregtinë e jashtme. U tha që USAID është sponsor i këtij ligji. USAID nuk është sponsor i këtij ligji, mirëpo ne përmes aktivitetit për përmirësimin e qeverisjes ekonomike kemi shqyrtuar këtë projektligj edhe kemi dhënë rekomandimet specifike që ai ligji të jetë në pajtim me parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe shpresojmë që të gjitha këto rekomandime të merren parasysh.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit shumë Dardane për këtë koment. Fjalën e ka z. Milazim Abazi nga Oda Amerikane.

Z. Milazim Abazi (ODA Ekonomike Amerikane në Kosovë):

Faleminderit! Atëher unë do të ngrisë tre iniciativa ligjore për avancimin e legjislacionit për tregjet e kapitalit dhe ka të bëjë me hartimin e: (1) Ligjit për Fondet Investive, (2) Ligjin për themelimin e Agjencisë për Regjistrimin e Letrave me Vlerë, dhe (3) Ligjin për Letrat me Vlerë. Me arsyetimin se në shtetet ku ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e funksionimit ekonomik, fondet investive kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të kapitalit, kryesisht në mobilizimin e kapitalit. Përgjatë gati 13 viteve të ekzistimit si shtet i pavarur, Republika e Kosovës nuk ka avancuar legjislacionin e saj për tregun e kapitalit, që do të mundësonte themelimin dhe funksionimin e fondeve investive, që si rrjedhojë do të pasuronte strukturën institucionale të sektori financiar, si dhe do të rriste konkurrencën në sektorin

financiar. Korniza aktuale arkaike ligjore e Republikës së Kosovës nuk i është përgjigjur nevojave të tregut duke ndikuar në kufizimin e inovacionit në treg.

Shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë një legjislacion solid për sa i përket fondeve investive, i cili është hartuar si përgjigje ndaj nevojave të zhvillimit të shpejtë të tregjeve të kapitalit, duke mundësuar kështu paraqitjen në treg të llojeve të ndërmjetësuesve financiarë. Marrëveshja për normalizim ekonomik e nënshkruar më 4 shtator 2020 në Uashington (SHBA), ka hapur një mundësi të re për financimin e sektorit privat nga Korporata Ndërkombëtare Financiare Zhvillimore e Shteteve të Bashkuara. Megjithatë derisa financimi direkt është i mundur vetëm për projekte që kalojnë një vlerë më të madhe monetare, financimi i projekteve në shkallë më të vogël do të mund të bëhej më lehtë përmes fondeve investive. Në pamundësi të themelimit dhe funksionimit të fondeve investive në Republikën e Kosovës, do të jenë fondet ndërkombëtare dhe rajonale, ato të cilat do të përfitojnë nga kjo mundësi. Prandaj, përmes Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Financave, që të nisë sa më shpejtë të jetë e mundur hartimi i legjislacionit për fondet investive i cili mes tjerash do të rregullonte: a) themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e fondeve investuese në Republikën e Kosovës; b) themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e depozitarëve të fondeve të investimeve kolektive; c) shitjen dhe marketimin e fondeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Kosovës ose jashtë saj; d) marketimin dhe administrimin e ndërmarrjeve të investimeve kolektive jashtë; e) Republikës së Kosovës nga fondet investuese të themeluara në Republikën e Kosovës. Përveç (1) Ligjit për Fondet Investive, duke iu referuar përvojës së shteteve të tjera fqinje, Kuvendi i Kosovës do të duhej të aprovonte edhe (2) Ligjin për themelimin e Agjencisë për Regjistrimin e Letrave me Vlerë, dhe (3) Ligjin për Letrat me Vlerë.

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit z. Abazi për këto komente! Besoj me kaq e kemi përmbyllë me diskutimet e sotme. Fjalën i'a kaloj Kryeministrit të Kosovës që të bëjë përmbylljen e takimit.

Avdullah Hoti (Kryeministër):

Ju falemnderit shumë Lindita. Më lejoni të ju falenderoj të gjithëve për komentet mbi sugjerimet dhe diskutimet, u zgjatëm ndoshta pak, mirëpo besoj se ishte një takim i frytshëm në kuptim të ndarjes së informative midis të gjitha institucioneve brenda qeverisë dhe sektorit privat. Dëshiroj të shfrytëzoj mundësin, të ju kërkoj mirëkuptim që ligji për rimëkëmbje ekonomike u vonua deri më tash dhe të ju falenderoj të gjitha odave e shoqatave për mbështetjen publike që i keni dhënë këtij ligji, dhe të ju kërkojmë që të kemi mbështetjen tuaj edhe më tutje deri sa të kryhet ky ligj. Duke e ditur që obligimi është tek qeveria dhe shumica parlamentare, shpresojmë që në ditë dhe javët e ardhshme të përmbylлим këtë çështje të rëndësishme dhe të hapim rrugë për lehtësim të aktivitetit ekonomik gjatë gjithë vitit 2021. E para unë edhe një herë kam kërkesë për ministrat e resoreve përkatës, që të kujdesen që për disa ditë përmes Lindites, odat ekonomike dhe shoqatat të marrin përgjigje për çështjet që i kanë ngritur. Për disa prej tyre u dhanë përgjigjet me gojë nga ministrat, por jo për të gjitha, andaj kërkoj nga ministrat që të shohin listen e çështjeve që i ka përmbledhur Lindita me ekipin e saj dhe të përgatisin përgjigjet me shkrim. Unë vlerësoj që nga ky diskutim ta kemi një dakordim. E para që të vazhdojmë të punojmë së bashku në masat që ndërlihen me rimëkëmbjen ekonomike për vitin 2020 me pakon ekzistuese. Për çështjet e Fondit për grate për 2 milion përmbillet javën e ardhshme, po ashtu edhe për komunitete. Ministri i

Bujqësisë është present me ne, 12 milion i kemi ndarë edhe 12 milion tjerë që bëjnë 24 milion për bujqësi. Edhe instrumenti tjetër që do jetë për biznese individuale, përreth 16000 biznese individuale. Për vitin 2021, si pjesë e rimëkëmbjes ekonomike, siç e thashë në fillim të takimit, në buxhet është parapar shumë prej 182 milion euro. Besoj që do të ketë mbështetjen e plotë të deputetëve, ndoshta edhe për tu rritur ky fond, por së paku 182 milion euro. Për këtë ju ftoj që gjatë dhjetorit të punojmë bashkë që t'i dizajnojmë masat dhe ndoshta në takimin e ardhshëm të këtij Këshilli t'i miratojmë ato masa, për mënyren e shpërndarjes së këtij fondi prej 182 milion, në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm, sepse atëherë ka me qenë intenziteti kur ne duhet të japim, intenziteti i pandemisë edhe efektet ekonomiko-sociale ku duhet t'u japim mbështetje bizneseve. Pra, ky është konkluzioni i parë, pako e rimëkëmbjes për këtë vit dhe vitin e ardhshëm. I dyti, unë sugjeroj që të nisim përgatitjet përmes mbështetjes së Linditës në komunikimin tonë për një pako të re fiskale, gjatë dhjetorit, dhe ta vendosim si objektivi tonin në mbledhjen e parë ose të dytë të qeverisë menjëher pas vitit të ri ta miratojmë këtë pako të re fiskale. Çka është kjo pako e re fiskale, do t'i adresojë të gjitha çështjet që i kanë ngritur odat ekonomike deri më tani, të përmbledhura nga Sekretariati i Këshillit. Ato çështje që i kanë ngritur odat, që kërkojnë ndryshim të rregulloreve dhe të udhëzimeve të ndryshme të ministrave përkatëse ose të agjencive, ose vendime ekzekutive të ministrave, agjencive ose qeverisë, ato do i adresojmë menjëherë dhe pastaj të shohim të hyjmë në një bashkëpunim më afatgjatë se cilat ligje duhet të ndryshohen.

Por unë insisto që të punojmë në përgatitjen e kësaj pakoje të re fiskale dhe që ta përgatisim gjatë dhjetorit në fillim të vitit të ardhshëm menjëherë, pra në mbledhjen e parë të Qeverisë ta miratojmë.

Pra me këto dy konkluzione po e përmbyll, nuk po e zgjas më shumë, ju falënderoj të gjithëve edhe për prezencën edhe për diskutimet në këtë mbledhje të Këshillit!

Lindita!

Lindita Daija (Sekretariati i KKEI):

Faleminderit i nderuar Kryeministër për këto komente, besoj që janë të mjaftueshme deri në takimin e rradhës! Sipas udhëzimeve të juaja ne do të vazhdojmë të punojmë në dy pikat e cekura dhe t'i informojmë të gjitha odat për pikat e mbetura, që mund të them në përqindje kanë mbetur 15% të pikave që nuk janë mbuluar nga ministrat, mirëpo do t'i përcjellim përmes emailit! Edhe njëhere ju falënderojmë për mirëkuptim për shtyrjen e datës dhe për kontributin tuaj në këtë dialog të mirëfilltë!